



UNIVERSITETI I PRIZRENIT “UKSHIN HOTI”

FAKULTETI EKONOMIK

DREJTIMI ADMINISTRIM BIZNESI-AGROBIZNES

PROGRAMI MËSIMOR – SYLLABUS-2016-2017							
Niveli i studimeve	Bachelor	Programi	Administrim Biznesi	Viti akademik	2016/17		
LËNDA		Prodhimi i Serrave					
Viti	Tretë	Statusi i lëndës	O	Kodi		ECTS kredi	5
Semestri	Pestë						
Javët mësimore		15		Orët mësimore 45		Ligjërata	Ushtrime
						2	1
Metodologjia e mësimit		Ligjërata, ushtrime, punime seminarike, konsultime, teste.					
Konsultime							
Mësimdhënësi		Prof. Ass. Dr. Isuf Lushi		e-mail	Isuf.lushi@uni-prizren.com		
				Tel.	049/547 171		
Asistenti				e-mail			
				Tel.			
Qëllimi studimor i lëndës					Përfitimet e studentit		
<p>Lënda Prodhimi i serrave ka për qëllim të paraqesë Prodhimin në mjedise të mbrojtura (Serra) të produkteve të perimeve, prodhimet që menaxhohen si zgjedhja e kushteve ekonomike, zbatimin e teknikave dhe teknologjive të reja, etj.</p> <p>Detyrë kryesore e kësaj lende është që të njiheni me aspekte të ndryshme të prodhimit të bimëve në mjedise të mbrojtura, në kushte të ndryshme agroekologjike si dhe me kërkesat e tyre ndaj faktorëve ekologjik. Gjithashtu do të njiheni me masat agroteknike që aplikohen në prodhimin të perimeve në serra, duke filluar nga fara cilësore deri tek vjelja, të cilat masa janë determinante në kuadrin e përcaktimit të rendimentit gjatë prodhimit të bimëve në serra. Pjesë e veçante e këtij moduli do të jenë kushtet mikro dhe makro klimatike në serra, ndërtimi dhe shfrytëzimi i serrave</p> <p>Që të njihen me aspektet kryesore të kultivimit të bimëve në Serra, kushtet mikro klimatike në serra, kushtet e ndërtimit dhe shfrytëzimit të serrave. Të njihen me rolin dhe efektin e faktorëve të veçantë në kultivimin e bimëve perimore në mjedise të mbrojtura, qoftë në fushë apo Serra, që nga zgjedhja e farës, faza e mbjelljes, menaxhimi i punëve, vjelja, procesi i pas vjeljes dhe plasimi i produkteve në treg.</p>					<p>Pas përfundimit të suksesshëm të ligjeratave, studentët do t'i zhvillojnë shkathtësitë dhe do të jenë në gjendje të :</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të njohin mirë kushtet e nevojshme për ngritjen e serrave 2. Të njohin kërkesat e bimëve ndaj kushteve mikroklimatike në serra 3. Të njohin masat specifike agroteknike që aplikohen gjatë kultivimit të bimëve në serra 4. Të njohin vjeljen dhe ruajtjen e produkteve në depo. 5. Të kenë njohuri për arritjen e rendimenteve të larta si qëllim i fundit të kultivimit në serra. 6. Mundësitë e lidhmërisë së kësaj lëmie me degët tera të Agrikulturës 7. Shpjegojnë përbërësit cilësore dhe sasior të 		

	prodhimeve të bimëve ne serra; 8. Përshkruajnë se si dieta, prodhimi i produkteve, mjedisi, barazia, popullsia dhe burimet tjera ndër-lidhen me njëra-tjetrën.
--	---

Metodologjia për realizimin e temave mësimore:

Ligjërata, ushtrime, qasje interaktive ,konsultime, punime seminarike .

Kushtet për realizimin e temës mësimore:

Literatura adekuate,përdorimi i mjeteve të TI.

Mënyra e vlerësimit të studentit (në%)

	Vlerësimi në %	Nota përfundimtare
Një punim seminarikë	Deri në 10 pikë dhe këto pikë vlerësohen në totalin e pikëve nga kollokviumi dhe testi përfundimtarë.	51-60%-nota 6
		61-70 7
		71-80 8
		81-90 9
Kollokviumi	50% të pikëve të mundshme+1 pikë kollokviumi konsiderohet i suksesshëm dhe pikët nga ky kollokvium u shtohen pikëve nga provimi përfundimtarë	
Testi përfundimtarë për provim	50% të pikëve të mundshme +1 pikë provimi vlerësohet pozitivë.Këtyre pikëve u shtohen pikët nga punimi seminarik dhe nga kollokviumi për të nxjerrë vlerësimin përfundimtarë. -Pikët nga kollokviumi dhe nga punimi seminarik,mirren per llogaritje të notës përfundimtare (nëse testi i provimit është pozitiv)vetëm në provimin e parë pas përfundimit të ligjëratave.	

Obligimet e studentit:

Ligjërata Studenti duhet të jetë i rregulltë në ligjërata dhe ushtrime, të shfrytëzoj të gjitha mundësitë për nxënie të dijes,të	Ushtrime Studenti duhet të jetë aktiv në ushtrime dhe të reflektoj gatishmëri dhe dije për iniciativa, ide dhe
---	---

përdorë literaturën e obliguar dhe më të gjerë, të jetë aktiv dhe të respektoj rregullat mbi shkollimin e lartë të etikës në mirësjellje dhe për bashkëpunim .	demonstrim të njohurive të marra në ligjërata.		
Ngarkesa e studentit për lëndën			
Aktiviteti	Orë	Ditë/Javë	Gjithsej:
Ligjërata	2	15 javë	30 orë
Ushtrime	1	15 javë	15 orë
Punë praktike			
Kontakte me mësimdhënësin/konsultime	0.5	15 javë	7.5 orë
Ushtrime në terren			
Seminare	0.8	15 javë	12 orë
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak	2	15 javë	30
Përgatitja përfundimtare për provim	2	15 Javë	30
Koha e kaluar në vlerësim(teste,kuize,provim final)			
Projekte,prezantime..etj			
Vërejtje: 1 ECTS kredi=25 orë angazhim,p.sh nëse lënda i ka 5 ECTS kredi student duhet të ketë angazhim gjatë semestrit 125 orë		Ngarkesa totale:	125

Java	Ligjërata	Orët	Ushtrime	Orët
1.	Tema Hyrje, Njohje me lëndën, Historiku dhe problemet e Serrave në Kosovë.	2	Ushtrime: Pyetje për diskutim.	1
2.	Kërkesat për faktorët e mjedisit. Parime te përgjithshme te Ndërtimit te serrave-Tipet, mbulesat e serrave.	2	Ushtrime: Punë praktike.	1
3.	Zgjedhja e vendit për ngritjen e serrave. Klasifikimi i mjediseve të mbrojtura(serrave).Ndërtimi i brendshëm. -Ngrohja, -Ftohja e serrave.	2	Ushtrime: Punë seminarike.	1
4.	Ujitja dhe te Ushqyerit e bimëve ne serra.	2	Ushtrime: Punë praktike. Punë seminarike .	1

5.	Zgjedhja e farës cilësore Substrati në të cilën kultivohen bimët, etj.	2	Ushtrime: Pyetje për diskutim dhe detyra (njohja e principeve bazë për prodhimin e produkteve të perimeve).	1
6.	Teknologjia e prodhimit të bimëve në serra. -Prodhimi i fidaneve	2	Ushtrime: Punë seminarike për një grup të studentëve.	1
7.	Kultivimi i perimeve Solanore në mjedise të mbrojtura. -Domatja	2	Detyra dhe konsultime për kolokfiumin e parë.	1
8.	Kollokfium	2		1
9.	Prodhimi i -Specit dhe -Patëllxhanit në serra.	2	Ushtrime: Punë praktike. Shembuj praktik lidhur me produktet e fresketa.	1
10.	Prodhimi i Perimeve të Familjes Bostanore: -Prodhimi i Kastravecit dhe -Pjeprit në serra.	2	Ushtrime: Shembuj lidhur me promovimin dhe tregtimin e produkteve.	1
11.	Prodhimi i Shalqinit në tunele të përkohshme.	2	Ushtrime. Pyetje për diskutim.	1
12.	Prodhimi i Spinaqit, Sallatës dhe Lakrës.	2	Ushtrime: Punë seminarike	1
13.	Prodhimi i Qepës në serra	2	Ushtrime: Punë seminarike për një grup të studentëve	1
14.	Prodhimi i Dredhëzës dhe bimëve zbukuruese në Serra.	2	Ushtrime: Punë seminarike për një grup të studentëve	1
15.	Konsulta dhe përgatitje për provim.	2	Ushtrime dhe konsultime për provim	1

LITERATURA

Literatura shtesë: Balliu, A. 2012. Mjediset e mbrojtura, Tiranë.

- ✚ Voci, F. 2000. Serrat dhe mjediset tjera të mbrojtura. Tiranë.
- ✚ Balliu, A. & Kaci, S. 2003. Kultivimi i Perimeve në Mjedise të Mbrojtura. Tiranë-Prishtinë.
- ✚ Mengel, K. Ernest, A. Kirgby, Harold K. Appel T. 2001.
- ✚ Perimtaria në mjedise të mbrojtura, 2011. Projekti, Masht/Danida, Prishtinë.
- ✚ Sinclair T. Gradner, F. 1998. Principles of ecology in plant production.
- ✚ Zaka, L., Boqi, P., Subashi, Y. 2010. Kultivimi i Luleshtrydhes, Lushnjë.
- ✚ Zajmi, A & Efendija T., Kultivimi i dredhëzës. 1996. Prishtinë.
- ✚ Thomas Sinclair, A. Weiss. 2010. Principles of plant production.
- ✚ Sinclair T, Gradner F. 1998. Principles of ecology in plant production.
- ✚ Mengel, K, Ernest A, Kirgby, Harold K, Appel T. 2001.
- ✚ Literature tjetër dhe materiale të ndryshme nga interneti.

VËREJTJE

Në mungesë të mundësisë që puna praktike të organizohet çdo javë, në bashkëpunim me menaxhmentin e Universitetit, ky aktivitet do të organizohet në ditë të caktuara në: bizneset që merren me prodhimin e perimeve në serra, njësitë përpunuese të produkteve të perimeve dhe kompanitë që merren me tregtimin e produkteve të perimeve.

Gjatë çdo ligjërate studenteve do të ju ofrohet materiale të ndryshme filmike (DVD, materiale tjera) lidhur me fermat për prodh perimeve dhe produktet e perimeve.

Për çdo temë mësimore, studentët do të pajisen me materiale të nevojshme në gjuhën shqipe;

Vërejtje për studentin:

Para së gjithash, studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore:

Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore;

Te mbaj disiplinën gjatë ligjëratave;

Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e indeksit në teste dhe provim;

Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet të përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësuesi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit.